Studiuesi i artit, Pjetër Logoreci ka dorëzuar në Arkivin e Shtetit një album me tre disqe gramafoni, me regjistrime të rralla të aktorit Aleksandër Moisiu

Zëri i aktorit Aleksandër Moisiu, tashmë në Arkivin e Shtetit

VALERIA DEDAJ

Pjetër Logoreci, studiues arti rik-thehet në Shqipëri kësaj here për të dorëzuar në Arkivin e Shtetit një album me tre disqe gramafoni. Në të është zëri i Aleksandër Moisut, aktorit me origjinë shqiptare. Pjesa e interpretuar prej tij, është monologu i Faustit të Gëtes. Studiuesi në një intervistë për "Shekullin" tregon se është një koleksionist i shumë materialeve që kanë të bëjnë me këtë aktor për jetën e tij në Vjenë. Gjithçka për të ka lindur vetëm nga një fotografi që ka parë në teatrin e Vjenës, ku për një vit rreth ka interpretuar në shfaqjen "Udhëtime" me regji të Kornmüller. "Edhe pse kushtonte "një dorë eurosh" e mora pa hezituar për ta pasur si "diamant" të familjes. Këtu ka një regjistrim të Moisiut, së bashku me zërin e Perandorit Franz Josef, zërin origjinal të famshmit kom-pozitor Straus".

Si ju ranë në duar tre pllaka grama-foni me zërin e Aleksandër Moisiut?

Ka kohë që kam filluar të kërkoj dhe të informohem mbi jetën e të madhit Aleksandër Moisiu. Ideja më erdhi nga një fotografi që pashë në teatrin e Vjenës ku unë kam luajtur për një vit rresht në shfaqjen "Udhëtimi" të regjisores gjermane Kornmüller. Në mes dokumenteve të shumtë që kam gjetur (të pabotuara) isha i "etur" të gjej dhe zërin e tij (origjinal). Fati e solli që në një treg gjërash të vjetra (libra, pllaka, kaseta etj) të më tërheq vëmendjen ky album që ishte një edi-cion i veçantë në 100 vjetorin e shtëpisë diskografike ku përmblidheshin gjërat më pikante të historisë Austriake. Në listën e 64 objekteve që ishin mbi pllakat ishte dhe monologu i Faustit (*Goethe*) interpretuar nga gjeniu i skenës së përbotshme, Moisiu. Edhe pse kushtonte "një dorë eurosh" e mora pa hezituar për ta pasur si "diamant" të familjes. Këtu ka një regjistrim të Moisiut në këtë studio diskografike e cila e ka vendosur në faqen e dytë të diskut të parë, së bashku me zërin e Perandorit Franz Josef, zërin origjinal të famshmit kompozitor Straus.

Përse vendosët që këtë material t'ia dhuroni Arkivit të Shtetit?

Pasi e kam pasur disa vjet rresht si krenaria e prejardhjes time shqiptare në shtëpi dhe me krenari ua kam treguar shumë personazheve të teatrit Austriak, vendosa që të jetë pronë e të gjithë bashkëkombësve të mi shqiptarë, që kushdo të këtë mundësinë të dëgjojë në origjinal këtë kryevepër kulmore e të përbotshme të aktrimit që kishte arritur Moisiu me talentin e tij prej gjeniu. Arsyeja tjetër është që arkivi i shtetit është vendi më i sigurt ku pasuria intelektuale e historike e kombit ruhet me fanatizëm.

Në 2011 në teatrin ku ka interpretuar dhe A. Moisiu ju keni qenë pjesë e shfaqjes "Udhëtimi", në një intervistë të dhënë asokohe keni shprehur entuziazmin tuaj për këtë fakt. Po realisht kush është për ju Aleksandër Mosiu, çfarë faktesh të tjera dini për jetën e tij?

Siç ju thashë dhe më sipër kisha dëshirë të dija më tepër për këtë figurë të madhe. U informova nga kolegët e teatrit popullor në Vjenë, që kishte një arkiv shumë të pasur të historisë së zhvillimit të teatrit Austriak, pjesë e së cilës ishte në një masë të madhe edhe kontributi e gjeniut tonë. Kam kërkuar në Arkivin e Teatrit me qëllim që të gjej dhe të botoj gjëra të panjohura më parë për "Sandrin" nga publiku shqiptar. Arkivi është i ndarë në fondin e fotografive, atë të letrave (ko-respondeca), reklamave (afisheve dhe posterave të pjesëve teatrore) dhe atë të jehonës së shtypit për shfaqjet e ndryshme. E shoqja e Moisiut, Johanna Terwin, i kishte dhuruar kësaj arkive pas vdekjes së tij, të gjithë dokumen-tacionin që ajo kishte mbledhur për të. Përveç se ajo ishte kolege e bashkëshorte e Moisut, ajo ishte edhe menaxherja e tij. Prandaj ishte kujdesur kurdoherë të ruante e të mblidhte pjesë nga jehona e jetës së tij artistike, si dhe korrespondencën e tij me kolegët, familjen, shkrimtarët drama-turgë, regjisorët e famshëm me të cilët punoj apo miqtë dhe studentet shqiptarë në Vjenë. Disponoj (përveç sa kam botuar) shumë dokumente të tjera që sjellin të reja mbi jetën e karrierën e tij, por që po i përpunoj për t'i botuar më pas.

PJETËR LOGORECI
studiues arti

Në mes dokumenteve të pabotuara isha i "etur" të gjej dhe zërin e tij "origjinal". Fati e solli që në një treg gjërash të vjetra (libra, pllaka, kaseta etj) të më tërheq vëmendjen ky album që kishte të rregjistruar zërin e Aleksandër Moisiut gjatë interpretimit të monologut te Fausti i Gëtes

Zbulimet e radha janë pjesë e punës që bëni, por dhe pasioni juaj. Jeta e panjohur të patriotëve shqiptarë ka qenë përherë në vëmendjen tuaj, ku-jtoj zbulimet për Kol Rrotën, eshtrat e Dom Nikollë Kaçorrit etj. Çfarë ju motivon ti bëni këto kërkime?

Përveç pasionit dhe dëshirës së mirë si shqiptar, kam edhe kohën e duhur në dis-pozicion për të ndjekur e kërkuar në tërë arkivat e Vjenës për figurat që kanë lë-në gjurmë në kohë, përveçse në histori-në tonë kombëtare, edhe në ambientet Austriake. Figura si Imzot Kaçorri, i cili i kushtoj jetën vendit të tij dhe që punoi me mish e shpirt edhe pse nën një represion të rëndë nga pushtuesit turq të cilët e përndo-qën dhe e dënuan me burg, figura si Alek-sandër Moisiu, Kolë Rrota, Gjergj Pekmezi, Nush Bushati (që do të nxjerr më pas), janë krenaria e çdo shqiptari që jeton në dhe të huaj, por edhe mbarë kombit tonë.

Përveç kësaj me çfarë tjetër jeni duke punuar?

Kam ende shumë materiale për Moisi-un për të punuar e botuar, por krahas tij dëshiroj të publikoj edhe disa materiale të tjera për Imzot Kaçorrin e patriotin Gjon Rrota vëllain e patriotëve Simon, Justin e Kolë Rrota.

Së fundmi është botuar një shkrim për Marie Logorecin, drejtuar Presi-dentit Bujar Nishani për dekorimin saj me titullin "Nderi i Kombit". Çfarë lidhje keni me të dhe si e shikoni fak-tin që për të nuk është bërë ende asnjë vlerësim?

Marie Logoreci ishte bashkëshortja e Kolë Logorecit (i nderuar me urdhrin e vlefshëm – Kalorës i Skënderbeut) i cili është nga rrethi im i ngushtë famil-jar. Mendoj se duhen lënë mënjanë para-gjykimet e këto figura të vlerësohen për kontributin me vlerë që kanë dhë-në. Jo vetëm profesionistët e artit, por i gjithë populli e dëshiron dhe e vlerëson "loken Marie", prandaj mendoj se ajo jo vetëm "fitoj bukën" në teatër, por edhe la mbrapa vepra për tu krenuar e thellësisht të bazuar mbi tabanin kombëtar. I kam shkruar edhe këshilltarit të Presidentit për çështjet kulturore Amik Kasaruhos, por nuk kam marrë asnjë përgjigje.